

# Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF)

## Çfarë duhet të merrni parasysh përpara se të investoni në një fermë blegtorale për prodhim qumështi!

Blegtoria mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë bujqësore të Shqipërisë, duke kontribuar me 45 % të vlerës së përgjithshme të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Numri i gjedhëve në vitin 2019 është 415.609 krerë, duke shënuar një rënie me 11.07 %, në krahasim me vitin 2018. Përqendrimi më i madh i numrit të krerëve është në Qarkun e Fierit me 16.33% dhe në Qarkun e Elbasanit me 10,38% ndaj numrit gjithsej të gjedhëve. Prodhimi i qumështit në vitin 2019 i referohet një vlere prej 1.11 milionë tonë, duke shënuar një rënie me 2.81%, në krahasim me vitin 2018. Struktura e prodhimit të qumështit, referuar vitit 2019 është: qumësht lope 85,11%, qumësht dele 7,34 % dhe qumësht dhie me 7.55 %. Rendimenti mesatar vjetor i qumështit të lopës në nivel vendi në 2019 është 2.981 kg për krerë duke u rritur me 2,23 %, krahasuar me 2018.

### Kriteret kryesore për investimet në blegtori

Nëse planifikoni të organizoni një fermë blegtorale, duhet të planifikoni me kujdes dhe të përllogarisni gjithçka, në vecanti:

- Projektimi i stallës dhe ambjenteve ndihmëse;
- Blerja e gjësë së gjallë produktive;
- Teknologjia e aplikuar;
- Sigurimi i bazës ushqimore;
- Ekspertiza veterinare dhe zooteknike;
- Burimet e financimit.

### Projektimi i Stallës

- Vendodhja e përshtatshme për ndërtimin e fermës;
- Sistemi i mbajtjes së gjedhit;
- Bokset për viça;
- Dyshemeja dhe rrasketat;
- Ventilimi;
- Shtroja;
- Grazhdet për marrjen e ushqimit;
- Bokset për pjellje dhe shërim të kafshëve;
- Ajrosja, ndriçimi, dritaret;
- Ujëpirëset;
- Vendi për mjelje;
- Hambari.


### Raca HOLTSEIN

Lopët Holstein dominojnë industrinë globale të qumështit duke arritur një prodhim të lartë të qumështit nga të gjitha racat në të gjithë botën. Kjo racë arrin një prodhimtari rreth 10,000 lit./vit. Raca Holstein është shumë e përshtatshme në Shqipëri.

### Baza Ushqimore

Ndikimi i ushqimit në mbarëshkrimin e gjedhit është në shumë drejtime. Nëpërmjet bazës ushqimore mund të ndikohet në zhvillimin e përgjithshëm të organizmit, në vetitë prodhuese të tyre, në kualitetin e tyre, në plleshmerinë e tyre, në rritjen e

Ndarja e gjedhit ne baze qarqesh



INSTAT 2019



Investimi i prezantuar mbështetet lehtësisht nga programi i granteve-“IPARD” dhe fondi i garancisë së BERZH-it dhe Qeverisë Shqiptare-“AASF”. Financimi i investimeve mund të përfshihet nën programin AASF, duke i ofruar kështu mundësinë bizneseve të përfitojnë nga kushtet lehtësuese të ofruara nga Institucionet Financiare Partnere të programit: ProCredit Bank, IntesaSanpaolo Bank, OTP Bank, Raiffeisen Bank dhe Fondi Besa.

Adela Leka, Drejtuese e Projektit AASF:  
[adela.leka@aasf.com.al](mailto:adela.leka@aasf.com.al)